

With funding from



AKSESI I VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË NDIHMËN EKONOMIKE

RAPORT

Tiranë 2022



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Ky raport është përgatitur në kuadrin e projektit “Advokatësi për aksesin ndaj ndihmës ekonomike për të mbijetuarat e dhunës në familje”, i cili zbatohet me mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) nëpërmjet AWEN.

“Ky material është plotësisht ose pjesërisht i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe AWEN. ADA dhe AWEN nuk janë domosdoshmërisht dakord me opinionin e shprehur. Vetëm autorët janë përgjegjës për përmbajtjen”.

Përgatitur nga:

Av. AURELA BOZO

Av. LIRIE DINA

LLM ILVANA DEDJA

Prof. Dr. AURELA ANASTASI

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE.....	4
DY FJALË PËR PROJEKTIN DHE METODOLOGJINË PËR HARTIMIN E RAPORTIT	5
I. NJË PËRMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR NË LIDHJE ME NDIHMËN EKONOMIKE PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE.....	7
I.1. Aktet ndërkombëtare.	7
I.2. Ligjet dhe aktet nënligjore që gjejnë zbatim për përfitimin e ndihmës ekonomike nga viktimat e dhunës në familje.	7
II. ASPEKTE TË ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR.....	
VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE	12
II.1. Reagimi pas Rekomandimit të KMD-së.	12
II.2. Gjetje të identifikuar nga informacionet e mbledhura nga bashkitë për mbarëvajtjen e ndihmës ekonomike të përfituar nga viktimat e dhunës në familje.	13
III. PRAKTIKA TË MIRA NË PËRGGJIGJE TË PROBLEMATIKAVE TË IDENTIFIKUARA.....	28
III.1. Në lidhje me datat e aplikimit,.....	28
III.2. Në lidhje me zbardhjen e vendimit nga gjykatat e rretheve gjyqësore,	28
III.3. Në lidhje me rastet e vendqëndrimit të përkohshëm të ndryshëm nga vendbanimi i përhershëm,	29
III.4. lidhje me informimin e viktimave të dhunës në familje mbi të drejtën e përfitimit të NE,.....	29
III.5. Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të KMD,.....	30
III.6. Në lidhje me mbështetjen e viktimave të dhunës në familje,	30
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	31
ANEKS I: TË DHËNA MBI VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE QË KANË PËRFITUAR NDIHMË EKONOMIKE GJATË 2020, 2021 DHE 2022 SIPAS BASHKIVE.	33

LISTA E SHKURTIMEVE

NE - Ndihma Ekonomike

UMM - Urdhër i Menjëhershëm i Mbrojtjes

UM - Urdhër i Mbrojtjes

KPrC - Kodi i Procedurës Civile

MSHMS - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

SHSSH - Shërbimi Social Shtetëror

KMD - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

KVDHF - Koordinator Vendor Kundër Dhunës në Familje

PMF - Punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve

QNL - Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

AWEN - Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

DY FJALË PËR PROJEKTIN DHE METODOLOGJINË PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, një organizatë jofitimprurëse që ka në misionin e saj mbështetjen, ndihmën dhe edukimin e shtetasve me qëllim rritjen e aksesit të tyre në sistemin e drejtësisë, po zbaton projektin “Advokaci për një akses efektiv të viktimave të dhunës në familje në ndihmën ekonomike”, me mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA). Në këtë kuadër, QNL ka përgatitur këtë raport në lidhje me aksesin e viktimave të dhunës në familje ndaj ndihmës ekonomike. Për përgatitjen e raportit janë përdorur të dhëna dhe informacione nga praktikantët e ndjekura nga QNL në mbështetje të viktimave të dhunës në familje, informacione nga drejtoritë e Shërbimeve Sociale pranë bashkive, rekomandime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe praktika të mira të Shërbimit Social Shtetëror, bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile.

Konkretisht, nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare është dërguar pranë bashkive kërkesë¹ me qëllim mbledhjen e informacionit në lidhje me viktimat e dhunës në familje të pajisura me UMM/UM që kanë përfituar ndihmë ekonomike. Është kërkuar informacion në lidhje me ankesat e paraqitura, aplikimet për NE pas datës 10 të muajit, trajtimin e rasteve në të cilat viktimat e dhunës në familje ka një vendqëndrim të ndryshëm nga vendbanimi i përhershëm, efektet e problemeve teknike të sistemit si dhe pengesat ligjore dhe praktike të identifikuar.

Në përgjigje të shkresës, QNL mori përgjigje nga 49 bashki. Duke qenë se SHSSH ka dërguar një shkresë zyrtare udhëzuese drejtuar 12 Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në muajin Korrik 2022, QNL ka kërkuar gjatë muajit Shtator 2022 informacion të përditësuar nga bashkitë mbi hapat e marra në zbatim të kësaj shkrese për periudhën Gusht-Shtator 2022. Në këtë shkresë është kërkuar informacion në lidhje me përfitimin e NE nga viktimat e dhunës në familje pavarësisht nëse vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe numrin e përfitueseve, përfitimin e NE nga viktimat kur UMM/UM është lëshuar nga gjykata pas datës 10 të muajit si edhe sfidat në zbatim të udhëzimeve të SHSSH. Për këtë, kemi marrë përgjigje nga një numër i lartë bashkish në vend, gjithsej 43 bashki.

¹ QNL, Kërkesë për informacion, nr.175.Prot, datë 25.07.2022.

Informacionet e përfthuara si më sipër, janë përpunuar për hartimin e këtij raporti.

Analiza e parashtruar në këtë raport është bazuar gjithashtu, edhe në përvojën e QNL-së në mbështetje të viktimave të dhunës në familje me ndihmë juridike falas. Nga kjo përvojë rezulton se nga 40 raste të viktimave të dhunës në familje të trajtuara gjatë vitit 2020, 4 prej tyre janë mbështetur nga avokatët e qendrës për çështje të aksesit në ndihmën ekonomike. Nga 109 viktima të dhunës në familje të mbështetura me ndihmë ligjore falas gjatë vitit 2021, 2 prej tyre janë mbështetur në lidhje me aksesin në ndihmën ekonomike. Ndërsa nga 92 viktima të dhunës në familje të mbështetura nga avokatet e qendrës gjatë vitit 2022, 10 prej tyre janë mbështetur në lidhje me çështje të aksesit në ndihmën ekonomike. Vihet re një rritje e numrit të grave viktimave të dhunës në familje, të cilat kanë kërkuar mbështetje për të përftuar ndihmën ekonomike.

Me anë të këtij monitorimi në lidhje me aksesin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në ndihmën ekonomike, kemi si qëllim të identifikojmë arritjet, boshllëqet, pengesat ligjore dhe praktike si dhe marrjen e masave me qëllim përfitimin e NE nga viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

I. NJË PËRMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR NË LIDHJE ME NDIHMËN EKONOMIKE PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE

Kuadri ligjor mbi ndihmën ekonomike për viktimat e dhunës në familje përfshin disa akte ndërkombëtare e kombëtare që rregullojnë çështje të barazisë dhe mos diskriminimit, si dhe të parandalimit të dhunës në familje. Objekti i monitorimit të këtij raporti lidhet ngushtë me përmbushjen e detyrimeve pozitive që duhet të marrë shtetit shqiptar për të mbështetur viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

I.1. Aktet ndërkombëtare.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit) vendos për shtetin shqiptar detyrime për të mbështetur viktimat e dhunës në familje me ndihmë mbështetëse e posaçërisht me ndihmë financiare: “marrja e masave të nevojshme legjislative ose masave të tjera për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime që lehtësojnë rehabilitimin e tyre nga dhuna. Këto masa duhet të përfshijnë, sipas nevojës, shërbime të tilla si konsulenca ligjore dhe psikologjike, ndihma financiare, strehimi, arsimi, trajnimi dhe ndihma në gjetjen e një pune”. (neni 20/1).

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) kërkon nga shtetet palë masa efektive për mbrojtjen e grave nga diskriminimi.

Komiteti CEDAW në vërejtjet e tij përmbyllëse për Shqipërinë të vitit 2016 i ka rekomanduar shtetit shqiptar në paragrafin 23.(b) “të forcojë rolin dhe kapacitetet e autoriteteve përkatëse në lidhje me mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore në përputhje me standardet ndërkombëtare”²;

I.2. Ligjet dhe aktet nënligjore që gjejnë zbatim për përfitimin e ndihmës ekonomike nga viktimat e dhunës në familje.

Zbatimi i Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”,

² <https://shendetesia.gov.al/rekomandime-dhe-konventa/>

i ndryshuar lidhet ngushtë me mbështetjen e viktimave të dhunës në familje që mbrohen me një urdhër mbrojtjeje.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në nenin 19, pika 6 parashikon se “Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohej. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbarrimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim”. Pra, Vendimi gjyqësor për lëshimin e UM është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij. (neni 23, p.1, Ligji për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare). Në paragrafin e parë sanksionohet detyrimi për zbatimin e Urdhrit të Mbrojtjes, nga momenti i shpalljes së tij nga gjykata kompetente, në rastin tonë, nga gjykata e shkallës së parë. Çasti i shpalljes nga kjo gjykatë e bën Urdhrin e Mbrojtjes titull ekzekutiv dhe të detyrueshëm për zbatim menjëherë³.

Sipas Nenit 17 të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes përmban (i) masën e caktuar nga gjykata; (ii) kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje; (iii) njoftimin se shkelja e urdhrit të mbrojtjes përbën vepër penale, dhe (iv) njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes.⁴ Cenimi i njërit prej elementëve mund të afektojë të drejtën për ndihmë ekonomike të viktimave të dhunës në familje.

Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes, i dërgon një kopje të tij jo vetëm viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim, por edhe zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim. Ky parashikim ligjor merr rëndësi jo vetëm në lidhje me përgjigjen institucionale për monitorimin e sigurisë së rastit por përbën një moment të rëndësishëm edhe për informimin e viktimës së pajisur me urdhër mbrojtjeje në lidhje me të drejtat e saj, përfshirë të drejtën për NE. Njohja e thelluar e ligjit kundër dhunës në familje nga administratorët shoqërorë është e një rëndësie të veçantë në kuadrin e trajtimit të rasteve me ndihmë ekonomike.

Ligji Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr.57/2019) ka për qëllim “*të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin*

³Mandro A.,Anastasi A.,Semini M, “Komentari i Ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Kreu i IV, f.237.

⁴ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Neni 17.

e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre”.⁵

Sipas Ligjit Nr. 57/2019, pika xh) “**Viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare**”, është çdo person, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, për të cilin është lëshuar urdhër mbrojtjeje ose urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje me vendim të gjykatës;

Në zbatim të ligjit “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi **VKM nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike**”. Kreu I, pika 2, pika d, përcakton se përfituesit e ndihmës ekonomike janë :.....(d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes ose të urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore. Pra, ndihmën Ekonomike e përfitojnë vetëm viktimat e dhunës në familje që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore për periudhën e vlefshmërisë së UMM ose UM të përcaktuar në vendimin e gjykatës.

Për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike, në Kreun I, pika 4.5, të VKM së sipërcituar përcaktohet se, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes ose të urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes paraqesin: (a) kopjen e kartës së identitetit, (b) urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes.

Ndërkohë, Ligji “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 16 të tij “**Aplikimi dhe përfitimi i ndihmës ekonomike**”, parashikon se aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës viktimat ka vendbanimin. Rrjedhimisht ngremë pyetjen: Si duhet të zgjidhet situata në rastet kur viktimat e dhunës në familje kanë vendqëndrim të përkohshëm të ndryshëm nga vendbanimi i përhershëm? Në rast ndryshimi të vendbanimit të familjes përfituese, krahas ndryshimit të gjendjes civile, transferohet edhe dosja e ndihmës ekonomike në bashkinë apo njësinë administrative të re, por në rastin e viktimave të dhunës në familje ato qëndrojnë përkohësisht në një vendbanim të ri dhe rekomandohet të përdorën zgjidhje që lehtësojnë aksesin e menjëhershëm të viktimës në ndihmën ekonomike.

⁵Ligji Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Neni 2.

Sipas pikës 4 të Kreut II të VKM nr.597, datë 04.09.2019 të sipërcituar, anëtarët madhorë të familjes/individët përfitues paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjendjen social-ekonomike të familjes. Ky detyrim në procedurën e aplikimit për NE mund t'i përballë viktimat e dhunës në familje me situata që cenojnë sigurinë e jetës, kur vendqëndrimi i tyre është i ndryshëm nga vendbanimi i përhershëm. Me ndryshimin që iu bë kësaj VKM-je, ndryshoi masa e ndihmës ekonomike.

Me miratimin e VKM Nr. 898 datë 29.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”⁶ u ndryshua edhe masa e ndihmës ekonomike për disa kategori. Aktualisht, duke filluar nga data 1 janar 2022, masa e ndihmës ekonomike që përfitojnë viktimat e dhunës në familje me Urdhër Mbrojtjeje nga 3000 lekë është bërë 9000 lekë.

Ka rëndësi të përmendim këtu se, në pikën 4 të nenit 16 të ligjit 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj nga bashkia nëpërmjet shërbimit bankar dhe/ose shërbimit postar, bazuar në vendimin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në rastet kur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë vendbanim të përkohshëm të ndryshëm nga vendbanimi i përhershëm, zbatohet shpërndarja e ndihmës ekonomike nëpërmjet shërbimit bankar.

Një vëmendje e vecantë shkon edhe për të drejtën e ankimit. **E drejta e ankimit në lidhje me aksesin e përfituesve në ndihmën ekonomike** është rregulluar në këtë ligj, por nevojitet të rritet niveli i informacionit të qytetarëve në lidhje me këtë të drejtë, institucionet ku duhet të drejtohen, afatet, etj.

Një akt tjetër ligjor që gjen zbatim në të gjitha çështjet që lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi, përfshirë edhe rastin e ndihmës ekonomike, është **Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar**. Ky ligj synon të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi në të gjitha format e tij edhe në të mira dhe shërbime, sikurse është rasti i ndihmës ekonomike. Neni 20, “Të mirat dhe shërbimet” ndalon diskriminimin nga personat fizikë dhe juridikë që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke përfshirë përfitimet nga skemat e mbrojtjes shoqërore, ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun.

⁶ Shiko: <https://www.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-29-dhjetor-2021/>

Në këtë kuadër, ka një rekomandim të KMD-së, nr.1636.prot, datë 25.11.2021, “Rekomandim për marrjen e masave për të siguruar aksesin paralel të viktimave të dhunës në familje, si një masë për të adresuar diskriminimin ndërsektorial”. KMD i ka rekomanduar Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, MSHMS dhe SHSSH, “Marrjen e masave për rishikimin e pikës 6 të nenit 12, të ligjit nr.57/2019 ‘Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë’ dhe pikës 12, të Kreut III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597, datë 4.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujorë të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, me qëllim sigurimin e aksesit paralel të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, si viktimat e dhunës dhe si kategori në nevojë, për shkak të mungesës ose pamjaftueshmërisë së të ardhurave”.


Rekomandim i KMD për marrjen e masave për të garantuar përfitimin në mënyrë efektive të ndihmës ekonomike, nga ana e viktimave të DHF kërkon:

- Shmangien e praktikës së kushtëzimit të NE për viktimat e DHF, me marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës për lëshimin e UM.
- Viktimat e DHF, të përfitojnë ndihmën ekonomike (NE) që nga momenti që gjykata me vendim, ka lëshuar UM.
- Viktimat e DHF, të përfitojnë ndihmën ekonomike (NE) që në momentin që gjykata merr vendimin për lëshimin e UMM dhe gjatë gjithë vlefshmërisë së tij, pavarësisht se kohëzgjatja është më pak se 1 (një) muaj.
- NJQV/administratorët shoqërorë, të procedojnë me aplikimin për ndihmë ekonomike, nëse viktimat DHF depozitojnë vendimin e shkurtër/dispozitivin e gjykatës që ka vendosur lëshimin e UM apo të UMM, me qëllim shmangien e vonesave në përfitimin e ndihmës ekonomike nga ana e viktimave të dhunës në familje, deri në zbardhjen e plotë të vendimit gjyqësor⁷.

⁷ KMD, Rekomandim nr.1002.Prot, datë 7.7.2022, “Rekomandim për marrjen e masave për të garantuar përfitimin në mënyrë efektive të ndihmës ekonomike, nga ana e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare”, drejtuar MSHMS, SHSSH, Bashkisë Tiranë, Bashkisë Kamëz, KLGJ.

II. ASPEKTE TË ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE

Rezultojnë një trend në rritje të viktimave të dhunës në familje, të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike. Në lidhje me mbështetjen e grave të dhunuara që kanë një urdhër mbrojtjeje, janë trajtuar me një pagesë 3000 lekë (rreth 25 euro) në muaj 408 gra në vitin 2018, 509 gra në vitin 2019, dhe 603 gra në vitin 2020⁸. “Për periudhën Janar - qershor 2022 rezultojnë se kanë përfituar ndihmë ekonomike 916 viktimat e dhunës në familje të pajisura me Urdhër Mbrojtje”⁹.



II.1. Reagimi pas Rekomandimit të KMD-së.

Shërbimi Social Shtetëror reagoi me shpejtësi pas Rekomandimit të KMD-së nr.1636.prot, datë 25.11.2021, “Rekomandim për marrjen e masave për të siguruar aksesin paralel të viktimave

⁸ MSHMS, RAPORT “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE ADRESUAR SHQIPËRISË NGA KOMITETI I PALËVE TË KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE”, Burimet financiare (neni 8),f.12, Qershor 2021. Ky raport është i vlefshëm në <https://shendetesia.gov.al/rekomandime-dhe-konventa/>

⁹ MSHMS, Informacion mbi dhunën në familje, 2021-2022. Shtator 2022. Ky informacion është ndarë në Mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore, viti 2022.

të dhunës në familje, si një masë për të adresuar diskriminimin ndërsektorial". Vihet re një përmirësim i qartë i situatës pas udhëzimeve të dërguara nga Shërbimi Social Shtetëror pranë Drejtorive Rajonale të SHSSH, në përgjigje të rekomandimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Jemi informuar nga disa bashki në vend dhe vijojmë të marrim informacione se viktimat e dhunës në familje të cilat kanë aplikuar pranë administratorit shoqëror nga data 1-10 e muajit kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe pse vendimi i gjykatës nuk ka qenë i formës së prerë¹⁰. Të pyetur në lidhje me të drejtën e viktimave në rastet kur UMM/UM është lëshuar nga gjykata pas datës 10 të muajit, jemi informuar se qytetarëve që janë në këtë situatë iu është dhënë e drejta të aplikojnë në muajin pasardhës dhe iu është njohur e drejta për NE pa humbur muajin në të cilin është lëshuar UMM/UM.

II.2. Gjetje të identifikuar nga informacionet e mbledhura nga bashkitë për mbarëvajtjen e ndihmës ekonomike të përfituar nga viktimat e dhunës në familje.

Nga informacionet e marra nga bashkitë janë identifikuar disa gjetje si më poshtë:

Së pari, kanë përfituar ndihmë ekonomike vetëm viktimat e dhunës në familje të pajisura me Urdhra Mbrojtje, bazuar në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar. Viktimat e dhunës në familje të pajisura vetëm me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike, megjithëse janë subjekt përfitues i njohur me ligj. Kjo ka sjellë një mospërputhje të dukshme midis numrit të viktimave të dhunës në familje të pajisura me UM ose UMM, dhe numrit të përfitueseve nga skema e ndihmës ekonomike¹¹.

Nga kthimi i përgjigjeve të drejtorive përkatëse, shihen qasje të ndryshme në lidhje me përfitimin nga skema e ndihmës ekonomike të viktimave të dhunës në familje të pajisura vetëm me UMM.

Sipas kthimit të përgjigjes së Bashkisë Kukës, viktimat e dhunës në familje të pajisura më UMM nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike, me arsyetimin se afati i aplikimit për të përfituar ndihmën ekonomike është muaj.¹² Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes jepet për një afat 21 ditë, ndërsa sistemi elektronik kombëtar pranon vetëm rastet kur aplikanti bashkëngjit UM, si një masë që shtrin efektet e tij ekzekutive në së paku 1 muaj.

¹⁰ Bashkia Lushnjë, nr.8246/1.Prot, datë 23/09/22, "Kthim përgjigje".

¹¹ Shih Aneks.1

¹² Kthim përgjigje drejtuar Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, Nr. 4808/, Prot. , datë 12.09.2022, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, Bashkia Kukës.

Kështu Bashkia Tiranë konfirmon se nuk ka pasur përfitues të ndihmës ekonomike të pajisur me UMM¹³.

Bashkia Klos ka konsideruar viktimat të dhunës në familje dhe kategori përfituese të ndihmës ekonomike vetëm viktimat që trajtohen me UM.¹⁴ Bashkia Klos ka përdorur gjithashtu projektet me donatorë të huaj. Nga fondet e dhëna nga projekti i "Fuqizimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhënie familje dhe dhunës ndaj grave në Klos" mbështetur nga PNUD, janë alokuar: 15 pako ushqimore për gra të dhunuara në vitin 2020, ndihmë financiare për 7 gra të dhunuara, dhe në 1 rast janë mbuluar shpenzimet gjyqësore të divorcit. Në Bashkinë Kukës, viktimat e dhunës në familje të pajisura me UMM nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike për faktin se afati i aplikimit për të përfituar ndihmën ekonomike është muajor.¹⁵

Në bashkinë Poliçan, viktimat e dhunës në familje nuk kanë përfituar nga skema, pasi kanë qenë të pajisur me UMM dhe jo UM. Pajisja vetëm me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje është evidentuar si një penalizim për të marrë pagesën, pasi UMM ka një afat 21 ditor, dhe sistemi elektronik për Ndihmën Ekonomike është muajor.

Së dyti, Lëshimi i UM pas datës 10 të muajit është një nga sfidat me të cilat përballen viktimat e dhunës në familje, të cilat humbasin ndihmën ekonomike për muajin në të cilin është lëshuar UM. Janë identifikuar raste të viktimave të pajisura me UM të cilat nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike të muajit në të cilin është lëshuar UM, në rastet kur vendimi i lëshimit të UM ka dalë pas datës 10 të muajit, për arsye se sistemi i ndihmës ekonomike qëndron i hapur për aplikim nga data 1-10 të çdo muaji.

Bazuar në Rekomandimin e institucionit të KMD i cili u vu në lëvizje nga Qendra "Të Drejtat e Njeriut në Demokraci", Shërbimi Social Shtetëror në Korrik 2022 ka udhëzuar drejtoritë rajonale të shërbimit social se "nisur nga fakti se sistemi i ndihmës ekonomike qëndron i hapur për aplikim nga data 1-10 të çdo muaji, për të gjitha ato raste kur Urdhri i Mbrojtjes ose Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes lëshohet nga gjykata pas datës 10 të çdo muaji, qytetarëve u jepet e drejta për të aplikuar në muajin pasardhës dhe e drejta e përfitimit shtrihet nga muaji i aplikimit përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Urdhrit të Mbrojtjes ose Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes pa humbur përfitimin e muajit përkatës në të cilin është lëshuar UM apo UMM nga gjykata".

¹³ Bashkia Tiranë, Nr.27092/1.Prot, datë 5.8.2022, "Kthim përgjigje".

¹⁴ Kthim përgjigje, Nr. 1950/1 Prot., Bashkia Klos, 09.08.2022.

¹⁵ Kthim përgjigje, Nr 4809/1. Poy., Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, Bashkia Kukës, 12.08.2022.

Bazuar në shkresën udhëzuese të Shërbimit Social Shtetëror drejtuar 12 Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror që orienton se qytetarëve ju jepet e drejta për aplikim gjatë muajit pasardhës, rezulton se janë marrë masa dhe po zbatohen ato në mbështetje të viktimave të dhunës në familje. Kështu Bashkia Berat informon se në rast se UM vjen pas datës 10 të muajit ose viktimat e pajisur me UM paraqitet pas kësaj date, viktimat njoftohen të vijë nga data 1-10 e muajit pasardhës¹⁶.

Pavarësisht udhëzimeve të SHSSH, qasjet nuk kanë rezultuar të unifikuara. Kështu, Bashkia Patos na ka informuar se, "...rastet të cilat e kanë marrë UM pas datës 10 të një muaji të caktuar kanë aplikuar muajin pasardhës dhe e kanë përfituar pagesën që prej muajit që kanë aplikuar, jo prej muajit që është lëshuar UM, kjo pasi nuk kemi pasur asnjë udhëzim nga SHSSH se si do të veprohet në këto raste"¹⁷. E njëjta qasje është konfirmuar edhe nga Bashkia Vlorë, sipas së cilës rastet e pajisura me UM të lëshuara pas datës 10 të muajit, aplikojnë në muajin pasardhës duke mos e përfituar muajin e lëshimit të UM. Edhe Bashkia Klos konfirmon se në rastet kur UM është lëshuar pas datës 10, viktimat e humbasin të drejtën e përfitimit pasi sistemi përlllogarit ndihmën në muajin që viktimat regjistrohet në sistem.¹⁸ Bashkia Fushë Arrëz, gjithashtu konfirmon këtë qëndrim¹⁹.

Znj. Miranda Pashaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK, pranë Shërbimit Social Shtetëror²⁰ shpjegon se: "Janë orientuar të gjitha drejtoritë rajonale dhe më pas të gjithë administratorët shoqërorë që edhe pse aplikimi mbyllet në datën 10 të muajit, dhe nuk mund të kryhet aplikimi për muajin e lëshimit të UM, të mos humbasë e drejta për muajin në cilin është lëshuar urdhri i mbrojtjes. Pra, nëse UM i mbaron efektet në muajin Maj, atëherë përfitimi i ndihmës ekonomike do të shtyhet deri në muajin pasardhës pra në muajin Qershor. Në këtë mënyrë përfitimi i NE do të merret i plotë sipas afatit të vlefshmërisë së UM".

Një aspekt i rëndësishëm për tu konsideruar është se viktimat e dhunës në familje janë në një situatë në të cilën nevojitet mbështetje e menjëhershme dhe aplikimi në muajin pasardhës mund të sjellë efekte në përmbushjen e nevojave të tyre bazë në muajin në të cilin është lëshuar UM. Nga ana tjetër, monitorimi i zbatimit nga administratorët/

¹⁶ Referuar shkresës, Bashkia Berat, Nr.3776/1.Prot, datë 25.08.2022.

¹⁷ Bashkia Patos, nr.2311/1.prot, datë 28.09.2022, "Kthim përgjigje".

¹⁸ Bashkia Klos, Nr.2420/1, datë 23.09.2022, "Kthim përgjigje".

¹⁹ Bashkia Fushë Arrëz, Nr.3696/1.prot, datë 21.9.2022, Kthim Përgjigje.

²⁰ Pjesëmarrëse në Tryezën on line me temë: "Arritje dhe sfida në lidhje me aksesin e viktimave të dhunës në familje në ndihmën ekonomike", organizuar nga QNL, më 29.09.2022;

bashkitë të këtyre masave dhe unifikimi i procedurës së përfitimit të NE në këto raste është i rekomandueshëm.

Sipas VKM nr.597, datë 4.9.2019, kreu II, pika 9, DRSHSSH është përgjegjëse për realizimin e procesit të vendimmarrjes brenda muajit të aplikimit të qytetarëve për ndihmë ekonomike, për pasojë pagesa përfitohet duke filluar nga muaji në të cilin kryhet aplikimi. Ky parashikim ligjor nuk zgjidh përfitimin e NE për muajin kur është lëshuar UM.

KMD ka rekomanduar për Bashkitë Tiranë dhe Kamëz që viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të përfitojnë ndihmën ekonomike që nga momenti që gjykata me vendim ka lëshuar Urdhrin e Mbrojtjes dhe zbatimi i këtij rekomandimi kërkon masa konkrete dhe efektive²¹.

Kufizimi në lidhje me datat në të cilat sistemi lejon aplikimin është përcjellë si një nga sfidat me të cilat përballen drejtoritë e shërbimeve sociale në vend. Kështu Bashkia e Malësisë së Madhe na ka informuar se “Sfida më e madhe që do veçonim do ishte fakti që sistemi të na lejojë që edhe pas datës 10 të muajit, të mund të bëjmë aplikimin për ndihmën ekonomike në rastet e UM, në mënyrë që të mos kalojë muaji dhe viktimat të mos trajtohet me ndihmë ekonomike”²². Gjithashtu, Bashkia Kurbin²³ identifikon këtë çështje si sfiduese.

Së treti, kanë rezultuar problematika të përfitimit të ndihmës ekonomike për viktimat e dhunës në familje që janë njëkohësisht individë në nevojë.

Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në bazë të nenit 7 të tij, ka përcaktuar se, subjekte përfituese të ndihmës ekonomike janë familjet dhe disa kategori individësh, midis të cilëve përfshihen viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare. Kriteret kryesore për përfitimin e ndihmës ekonomike nga ana e familjeve, janë mungesa e të ardhurave ose të ardhura të pamjaftueshme. Megjithatë, për viktimat e dhunës në familje kriteri i përfitimit të ndihmës ekonomike nuk kushtëzohet nga të ardhurat, por vetëm me faktin që individi të jetë i pajisur me urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes. Ndihma ekonomike përfitohet vetëm gjatë vlefshmërisë së urdhurave të mbrojtjes dhe individi nuk duhet të jetë duke u trajtuar në institucionet e përkujdesjes shoqërore. Në këto kushte, viktimat e dhunës në familje duhet ta përfitojnë këtë ndihmë pavarësisht nëse është e përfshirë në ndonjë nga skemat e tjera të mbështetjes.

²¹ KMD, Rekomandim nr.1002.Prot, datë 7.7.2022, “Rekomandim për marrjen e masave për të garantuar përfitimin në mënyrë efektive të ndihmës ekonomike, nga ana e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare”, drejtuar MSHMS, SHSSH, Bashkisë Tiranë, Bashkisë Kamëz, KLGJ.

²² Bashkia Malësi e Madhe, nr.2778/1.prot, datë 29.9.2022, Kthim përgjigje.

²³ Bashkia Kurbin, nr.4967/1.prot, datë 29.9.2022, “Dërgim informacioni”

“Sipas legjislacionit në fuqi, e drejta e aplikimit në skemën e ndihmës ekonomike i njihet çdo individ/familje në nevojë të cilat nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme. Çdo familje/individ në nevojë, përfshi këtu edhe viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, gëzojnë të drejtën për të aplikuar në skemën e ndihmës ekonomike si kategori e veçantë, por edhe si familje në nevojë, duke respektuar përcaktimet e pikës 12, Kreu III, të VKM nr. 597, datë 4.9.2019, në të cilën përcaktohet se: Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, invalid pune apo individ, përfitues i ndihmës ekonomike, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen. Pra një individ, i cili është i pajisur me urdhër mbrojtje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtje, mund të aplikojë për përfitim të ndihmës ekonomike si anëtar i familjes në nevojë, por nuk i llogaritet masë përfitimi në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen”²⁴.

Ky shqetësim është ngritur nga përfaqësues të shoqërisë civile gjatë viteve të fundit. Denada Shpuza, Drejtore Ekzekutive e Qendrës “Hapa të Lehtë Shkodër” shprehet se: “Vlerësojmë se është e nevojshme përgatitja e një udhëzuesi/memo dërguar të gjitha bashkive në vend me qëllim një orientim të unifikuar të zbatimit të legjislacionit mbi ndihmën ekonomike për viktimat e dhunës në familje. Viktimat e Dhunës mund të kenë specifika të ndryshme, por pavarësisht statusit që ato gëzojnë (invalid, ndihmë ekonomike, të papunë, etj.) nuk duhet të penalizohen në mbështetjen financiare që ato përfitojnë në bazë të ligjit si viktimat e Dhunës në Familje të pajisura me urdhër mbrojtje”.

Bazuar në informacionin dhe në parashtrimet nga Qendra “Të drejtat e Njeriut në Demokraci” (në vijim QDNjD)²⁵, Komisioneri, në ushtrim të kompetencës së parashikuar nga neni 32/1/c i ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, me urdhrin nr. 1 datë 06.01.2021, filloi procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes mbi aksesin paralel të viktimave të dhunës në familje në skemën e mbështetjes ekonomike, si kategori në nevojë dhe si viktimë dhune.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandoi marrjen e masave për rishikimin e pikës 6, të nenit 12, të ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 12, të Kreut III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 4.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, me qëllim sigurimin e aksesit paralel të viktimave të dhunës në marrëdhënie familjare, si viktimat e dhunës dhe si kategori në nevojë, për shkak të mungesës ose pamjaftueshmërisë

²⁴ Rekomandim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nr.1636.Prot, datë 25.11.2021.

²⁵ Informacioni administruar me shkresat nr. 1754 prot., datë 15.12.2020 dhe nr. 1850 prot., datë 29.12.2020.

së të ardhurave”²⁶. Monitorimi i zbatimit të këtij rekomandimi dhe roli aktiv në përmirësimin e kuadrit ligjor për NE për viktimat e dhunës në familje janë hapa të rëndësishëm që mund të ndërmerren nga shoqëria civile në zbatim të rekomandimit të KMD.

Së katërti, sikurse e theksuam, ligji në nenin 16 të tij “Aplikimi dhe përfitimi i ndihmës ekonomike” parashikon se aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin kërkuesi. Nëse viktimat nuk janë regjistruar në gjendjen civile të bashkisë ku po qëndrojnë përkohësisht, atëherë ato nuk mund të jenë përfitues në këtë bashki/njësi administrative, por do jenë në bashkinë/njësinë administrative ku janë regjistruar. Regjistri elektronik është i lidhur me gjendjen civile. Ky parashikim ligjor përball me sfida të sigurisë së jetës viktimat e dhunës në familje që zgjedhin një vendqëndrim të përkohshëm të ndryshëm nga vendbanimi i përhershëm.

Në respektim të ligjit, nuk janë pranuar kërkesat për NE të viktimave që nuk janë të regjistruara pranë gjendjes civile të bashkisë/NJA ku viktima ka vendqëndrimin e përkohshëm. Bashkitë janë shprehur qartë se viktimat e dhunës në familje duhet të aplikojnë pranë administratorit shoqëror në Bashki/Njësi Administrative ku kanë vendbanimin e përhershëm dhe mund të përfitojnë ndihmën ekonomike vetëm pranë kësaj Njësie.²⁷

Si duhet të zgjidhet situata në rastet kur viktimat e dhunës në familje kanë vendqëndrim të përkohshëm të ndryshëm nga vendbanimi i përhershëm?! Përgjigja që jep legjislacioni është ndryshimi i gjendjes civile dhe transferimi i dosjes së ndihmës ekonomike. Në rastet e ndryshimit të vendbanimit të familjes përfituese, krahas ndryshimit të gjendjes civile, transferohet edhe dosja e ndihmës ekonomike në bashkinë apo njësinë administrative të re, por në rastin e viktimave të dhunës në familje ato qëndrojnë përkohësisht në një vendbanim të ri dhe rekomandohet të përdoren zgjidhje që lehtësojnë aksesin e menjëhershëm të viktimës në ndihmën ekonomike. Janë identifikuar praktika shumë të mira të bashkëpunimit mes bashkive të vendbanimit të përhershëm dhe vendqëndrimit të përkohshëm të viktimës, në lidhje me menaxhimin e rastit si dhe në lidhje me ndryshimin e gjendjes civile dhe dërgimin e dosjes së ndihmës ekonomike.

Bashkia Berat: “Viktima e dhunës në familje e përfiton ndihmën ekonomike në atë bashki apo njësi administrative ku është regjistruar në gjendjen civile, pavarësisht se ku ndodh dhuna, ku bëhet denoncimi apo cila gjykatë e lëshon UM. ...Kemi referuar raste në bashki të tjera ku viktima është e regjistruar në gjendjen civile si edhe kemi marrë referime, në mënyrë që ato të mos e humbasin të drejtën për të përfituar ndihmën ekonomike” (Nr.3776/1.

²⁶ Rekomandim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nr.1636.Prot, datë 25.11.2021.

²⁷ Bashkia Shkodër, Nr.2001/1.Prot, datë 12.08.2022, “Përgjigje shkresës nr.209, datë 25.07.2022.

Prot. datë 25.08.2022, "Kthim përgjigje").

Në lidhje me aplikimin për ndihmë ekonomike, kur viktimat është larguar nga vendbanimi i përhershëm dhe përballet me rrisqe për jetën, është e nevojshme të identifikohen mundësi konkrete që lehtësojnë përfitimin e ndihmës ekonomike. Një viktimitë e dhunës në familje e sapo pajisur me UMM është në rrezik të lartë për jetën dhe largimi i saj, në raste të caktuara së bashku me fëmijët mund ta përballë me incidente dhune.

Informacioni i dhënë gjatë plotësimit të aplikimit mund të verifikohet edhe në mënyrë elektronike me institucionet e tjera shtetërore, pa vënë në rrezik jetën e viktimës, duke i kërkuar të paraqitet pranë administratorit përkatës në njësinë administrative. Në rastet e viktimitave të dhunës në familje, informacioni i dhënë nga viktimat se është e pajisur me urdhër të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhër mbrojtje mund të verifikohet menjëherë me koordinatoren vendore kundër dhunës në familje, drejtorinë e shërbimeve sociale në bashki dhe policinë, të cilat janë institucione që iu dërgohet kopje e vendimit të UMM/UM si dhe me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.

Në lidhje me deklarin e viktimitës së dhunës në familje çdo tre muaj pranë administratorit shoqëror, kërkohen edhe parashikime në lidhje me bashkëpunimin mes administratorit të njësisë administrative ku ka vendbanimin me administratorin e njësisë administrative ku ka vendqëndrimin, me qëllim kryerjen e vizitave në familje.

Në rastet kur viktimat nuk e kanë lejen e banimit pranë bashkisë përkatëse, evidentohen disa praktika të ndryshme të ndjekura nga Drejtoritë e Shërbimit Social në bashki të ndryshme.

Në shumë raste, viktimat e dhunës në familje duhet të aplikojnë dhe të marrin pagesën në vendin ku kanë gjendjen civile, për shkak se Administratori Shoqëror i Ndihmës Ekonomike duhet të kryejë vizitën në banesën familjare dhe të monitorojë UM/UMM dhe ndihmën ekonomike. Në bashkinë Poliçan, në rastet kur viktimat ndodhet në një juridiksion tjetër administrativ, kjo është pengesë për administratorin të kryejë detyrat e tij ligjore. Për sa më sipër, administratori nuk mund të kontrollojë personin/familjen jashtë juridiksionit të vet administrativ, por kërkohet ndryshimi i vendbanimit nga personi. Në këtë mënyrë transferohet dosja elektronike dhe fizike në Njësinë Administrative ku është vendosur viktimat për sa kohë është në fuqi UM.²⁸

Në bashkinë Sarandë, nëpunësit ndjekin praktikën e referimit të viktimitave nëpër organizata

²⁸ Dërgim informacioni, Nr 1346/1 Prot., Sektori i Shërbimeve Sociale, Bashkia Polican, 04.08.2022.

jo fitimprurëse për shkak të mohimit të së drejtës në skemën e ndihmës ekonomike.²⁹ Të njëjtën praktikë ndjek dhe bashkia Konispol. Rastet që kanë UMM/UM dhe nuk kanë vendbanimin e përhershëm në Bashki asistohen me këshillim, pako ushqimore, referime pranë organizatave jofitimprurëse, zyrave të punës dhe institucioneve të tjera sipas nevojës.³⁰

Në raste kur viktimat e dhunës në familje ka një vendbanim të përkohshëm të ndryshëm nga vendbanimi i përhershëm, në Bashkinë Klos rasti trajtohet në bashkëpunim me koordinatorin vendor për dhunën në familje, në territorin e bashkisë në të cilën jeton viktimat. Pavarësisht kësaj, viktimat mund të aplikojnë dhe të marrin ndihmën ekonomike vetëm pranë bashkisë në të cilën ka vendbanimin sipas gjendjes civile.

Në përgjithësi, ky parashikim ligjor është vlerësuar si problematik për viktimat e dhunës në familje. Sipas Bashkisë Shkodër, kjo përbën një pengesë të madhe për përfitimin e NE, pasi ka viktimat të cilat për shkak të situatës social ekonomike e kanë të pamundur lëvizjen për të bërë aplikimin për herë të parë dhe paraqitjen çdo tre muaj për të bërë deklaratën.³¹

Shpërndarja e ndihmës ekonomike nëpërmjet shërbimit bankar është lehtësuese në këto raste, bazuar në pikën 4 të nenit 16 të ligjit parashikohet se, “Ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj nga bashkia nëpërmjet shërbimit bankar dhe/ose shërbimit postar, bazuar në vendimin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror”.

Së pesti, janë identifikuar raste ku bankat e nivelit të dytë tërheqin shumën e përfituar nga NE, në rastet kur viktimat kanë kredi apo detyrime për të shlyer³². Masa e ndihmës ekonomike është shumë e rëndësishme për nevojat imediate të viktimave që përballen me dhunë në familje dhe cenimi i saj prek nevojat bazë të tyre.

Neni 533 i K.Pr.C, “Sekuestroja e pagës së debitorit” (ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008) parashikon se “Pasi zbritet kontributi për sigurimet shoqërore dhe taksat mbi të ardhurat, përmbaruesi gjyqësor sekuestron pagën e debitorit, por pa cenuar minimumin jetik, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi”. Sipas nenit 529 të K.Pr.C, pika 6, nuk mund të vihet sekuestro mbi ndihmën që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Përfshirja e ndihmës ekonomike për viktimat e dhunës në familje të pajisura me UMM/UM që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesit shoqëror

²⁹ Kthim përgjigje dhe Informacion mbi Viktimat e dhunës, Nr 3312/1 prot., Bashkia Sarandë, 09.02.2022.

³⁰ Kthim përgjigje, Nr. 855 Prot., Zyra e Mbrojtjes Sociale, Bashkia Konispol, 09.08.2022.

³¹ Përgjigje shkresës nr 209 prot. Dt. 25.07.2022, Bashkia Shkodër, Drejtoria e ndihmës Ekonomike dhe PAK, Nr. 2001/1 Prot , datë 12.08.2022.

³² Bashkia Krujë, nr.4709/1.prot, datë 2.8.2022, “Kthim përgjigje”.

është e rekomandueshme. Kjo bëhet edhe më thelbësore kur në UM përfshihen edhe fëmijët dhe NE është shumë e rëndësishme për mirërritjen e tyre.

Së gjashti, viktimat e dhunës në familje kanë informacion të kufizuar në lidhje me dokumentacionin në momentin e aplikimit, të drejtën e ankimit, etj. Nga monitorimi i rasteve të mbështetura me ndihmë ligjore falas nga avokatet e QNL, janë identifikuar raste kur viktimat e dhunës në familje nuk kanë pasur informacion në lidhje me aplikimin dhe dokumentacionin përkatës dhe kjo iu ka kushtuar humbjen e ndihmës ekonomike për disa muaj³³. Viktimat e dhunës në familje që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, kur aplikojnë për ndihmë ekonomike duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror: i) Urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes; ii) Fotokopje të kartës së identitetit të aplikuesit. Roli i organizatave të shoqërisë civile është i një rëndësie të veçantë, me qëllim informimin e viktimave mbi të drejtën për ndihmë ekonomike, ndryshimet ligjore në lidhje me këtë të drejtë, institucionet ku duhet të drejtohen, paraqitjen e informacioneve/ankesave për institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, institucionin e Avokatit të Popullit, etj. Informimi i viktimës së dhunës në lidhje me të drejtën për NE që në momentin e parë të raportimit të dhunës është shumë i rëndësishëm.

Viktimat e dhunës në familje që janë mbështetur nga avokatët e organizatave jofitimprurëse gjatë procesit gjyqësor të lëshimit të UMM/UM, informohen mbi të drejtën e tyre për të përfituar ndihmë ekonomike si viktimat e dhunës në familje, si dhe këshillohen të drejtohen sa më shpejt të jetë e mundur pranë zyrave të bashkisë për të kryer aplikimin. Viktimat e dhunës në familje, të cilat kanë ndjekur të vetme procesin gjyqësor të lëshimit të UMM/UM nuk kanë pasur mundësi të marrin këshillim ligjor për çështjet e dhunës apo mbështetjen me NE. Ato nuk kanë pasur informacion mbi këtë të drejtë, afatet e aplikimit dhe përfitimin. Në këto kushte, ato nuk paraqiten pranë bashkisë për të aplikuar për ndihmë ekonomike duke e humbur këtë të drejtë për muaj të caktuar.

Gjykata dërgon një kopje të vendimeve të UMM/UM pranë sektorit të shërbimeve sociale në çdo bashki. Ndaj, sugjerojmë që ky sektor, në bashkëpunim me KVDHF, pasi të vihet në dijeni për kopjet e UMM/UM të dërguara nga gjykata, të vihet në kontakt menjëherë me viktimën e dhunës në familje, me qëllim për ta informuar për të drejtën e aplikimit për ndihmë ekonomike, afatin kohor brenda të cilit mund të aplikojë si dhe procedurat e aplikimit.

³³ Bashkia Kavajë, nr.3237/1.prot, datë 29.9.2022, "Kthim përgjigje", "Rasti është paraqitur në Shtator për aplikim ndërkohë që data e përfitimit sipas UM është Mars 2022, pra ka humbur kështu 6 muaj"

Së shtati, një nga praktikat e identifikuara në rastet e mbështetura me ndihmë ligjore falas nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare lidhet me përfitimin e fëmijëve nga NE, megjithëse UM është lëshuar nga gjykata vetëm në favor të viktimës, por masat mbrojtëse përfshijnë edhe fëmijët. Kjo përvojë është ndarë mes bashkive dhe aktualisht përbën një përvojë të konsoliduar në disa prej tyre.

Një nga përfitueset e ndihmës juridike falas nga avokatet e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, K.Z. shprehet se ajo ka aplikuar pranë NJA nr.2 në Bashkinë Tiranë dhe ka përfituar ndihmë ekonomike për vete dhe dy fëmijët e saj të përfshirë në urdhrin e mbrojtjes³⁴.

Disa nga bashkitë kanë ngritur pyetjen nëse duhen trajtuar me NE disa anëtarë të një familje kur ata janë viktimë të dhunës në familje të pajisur me UMM/UM. Bashkia Berat na ka informuar se *“...Do të veçonim rastet kur me UM janë pajisur jo një por dy apo më shumë anëtarë të një familjeje.....Në raste të tilla ne si Drejtori e Shërbimit Social kemi dhënë ndihmë ekonomike vetëm për një nga anëtarët jo për secilin pasi ligji nuk e specifikon këtë pjesë”*.

Qëndrimi i Bashkisë Mirditë është i ndryshëm. Në këtë bashki për periudhën Gusht-Shtator 2022 është mbështetur me ndihmë ekonomike 1 (një) rast, me pesë viktimë, rast i cili ka qenë i pajisur me vendim gjykate për Urdhër Mbrojtjeje.

Së teti, Në lidhje me ankesat mbi aksesin në ndihmën ekonomike, në bashkinë Kamëz, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë paraqitur fizikisht gjatë kohës së aplikimit për tu ankuar në lidhje me aksesin në skemën e ndihmës ekonomike. Referuar ankesave, objekti i tyre lidhet me përfitimin e NE si viktimë dhune që në momentin që individi ka tërhequr vendimin e gjykatës (për lëshimin e UM)³⁵. Këto raste nuk janë zgjidhur, pasi sistemi i ndihmës ekonomike është i disponueshëm vetëm nga data 1 deri në datën 10 të çdo muaji, duke i mohuar të drejtën e përfitimit aplikantëve nga data 11.³⁶

Në bashkinë Krujë, ankesat e viktimave të dhunës në familje janë zgjidhur dhe ofruar ndihmë sipas ligjit, duke dëgjuar ankesat, shqyrtuar rastet dhe duke studiuar vështirësitë ekonomike dhe sociale specifike nëpërmjet vizitave në familje, GTN-ve, bashkëpunimit me përfaqësues nga Qendra e të Drejtave të Njeriut në Demokraci, OJF-ve të ndryshme, duke i mbështetur dhe asistuar me çdo nevojë.³⁷

³⁴ Nga intervista me përfituesen e QNL, K.Z e realizuar nga një nga avokatet e qendrës në datën 23.09.2022.

³⁵ Shënim i monitorueseve.

³⁶ Kthim përgjigje, nr. 6796/1/1. Prot., Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, Bashkia Kamëz, 05.08.2022.

³⁷ Kthim përgjigje, nr. 1083 Prot., Bashkia Krujë, 11.08.2022.

Disa nga bashkitë ndajnë informacionin se nuk kanë marrë ankesa gjatë këtyre tre viteve në lidhje me përfitimin e ndihmës ekonomike nga viktimat e dhunës në familje. Informimi i viktimave nga KVDHF rekomandohet të fokusohet edhe në të drejtën e ankimit në lidhje me aksesin në NE, duke i shpjeguar afatin kohor të paraqitjes me shkrim pranë bashkisë/njesisë administrative, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit, njoftimin e viktimës së dhunës në familje nga struktura vendore brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga marrja e ankesës, të drejtën për paraqitjen e ankesës pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, si dhe të drejtën për të ngritur padi në gjykatë pas ezaurimit të gjithë rrugëve administrative.

Së nënti, Një problematikë e identifikuar në disa nga bashkitë e vendit është kushtëzimi i përfitimit të NE me paraqitjen nga viktimat të urdhrave të mbrojtjes të formës së prerë.

Megjithëse sipas nenit 21/2 ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar parashikohet se: “Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose të urdhrit të mbrojtjes”, praktika që ndiqet nga organet e vetëqeverisjes vendore është e tillë që viktimave të dhunës në familje ju kërkohet në çdo rast vendimi i formës së prerë për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Nga monitorimi, evidentohen disa raste në lidhje me këtë problematikë.

Avokatet e QNL sjellin rastin e Z.I³⁸, viktimë e dhunës në familje e cila nuk është mbështetur me NE nga Bashkia Tiranë me arsyetimin se vendimi i UM nuk ka marrë formë të prerë. Neni 23, pika 1 e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, ka parashikuar se *vendimi gjyqësor për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij*. Referuar këtij neni, vendimi gjyqësor për lëshimin e UM përbën titull ekzekutiv dhe duhet të ekzekutohet nga të gjitha institucionet që i drejtohet, menjëherë pavarësisht nëse ka marrë ose jo formë të prerë.

Pyetjes, “A kanë përfituar viktimat e dhunës në familje që kanë aplikuar pranë administratorit shoqëror nga data 1-10 të muajit, pavarësisht se vendimi i gjykatës për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes nuk ka qenë i formës së prerë?”, Bashkia Roskovec i është përgjigjur: “Nuk kemi pasur raste të tilla sepse ligji është i qartë, viktimat e dhunës në familje duhet të kenë marrë vendim të formës së prerë”.

³⁸ Z.I. është mbështetur me ndihmë ligjore falas nga avokatet e QNL gjatë vitit 2021.

Bashkia Krujë ka përcjellë informacionin se: “Viktimat e dhunës në familje nuk e përfitojnë dot ndihmën ekonomike nëse vendimi i gjykatës nuk është i formës së prerë sepse sistemi i ndihmës ekonomike funksionon me një sistem pikëzimi që verifikon të dhënat e personave dhe del automatikisht jo përfitues. Në periudhën Gusht-Shtator janë mbështetur me ndihmë ekonomike 18 viktima të dhunës në familje, të gjitha me vendimin e formës së prerë të gjykatës, duke përjashtuar ato që nuk kanë pasur një vendim të formës së prerë”³⁹.

Bashkia Gjirokastrë informon se për periudhën Gusht-Shtator 2022 janë mbështetur me ndihmë ekonomike 13 raste të cilat kanë qenë me vendim të formës së prerë⁴⁰.

Legjislacioni për ndihmën ekonomike nuk parashikon një detyrim të tillë për përfitimin e NE nga viktimat e dhunës në familje dhe kërkon nga viktima aplikante paraqitjen e urdhrave të mbrojtjes, pa specifikuar nëse duhet të jenë të formës së prerë. Nuk mungojnë praktikatat që ia njohin viktimës këtë të drejtë pavarësisht ankimit të vendimit, në përgjigje edhe të udhëzimeve të SHSSH.

Shërbimi Social Shtetëror në Korrik 2022⁴¹, në zbatim të rekomandimit të KMD për marrjen e masave për të garantuar përfitimin në mënyrë efektive të ndihmës ekonomike nga ana e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare ka udhëzuar 12 Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror se, “Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të pajisura me Urdhër Mbrojtje ose Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje kanë të drejtë të aplikojnë pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore në bashkitë/njësitë vendore nga data 1-10 të çdo muaji, për të përfituar ndihmë ekonomike me dokumentet e përcaktuara UM ose UMM të lëshuara nga gjykata dhe pa qenë të detyruar për tu pajisur me një vendim gjyqësor të formës së prerë”.

Bashkia Elbasan sjell këtë përvojë: sipas nenit 19/6, të ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, zyrat e shërbimeve sociale të njësive së vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin që të ofrojnë shërbime (përfshirë ndihmën ekonomike) për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare që nga momenti i lëshimit të UMM.Të gjithë rastet informohen dhe orientohen të paraqiten pranë Njësisë Administrative përkatëse dhe të kryejnë aplikimin për të përfituar Ndihmën Ekonomike.⁴²

³⁹ Bashkia Krujë, nr.6109.prot, datë 26.9.2022, “Kthim përgjigje”.

⁴⁰ Bashkia Gjirokastrë, nr.10393.prot, datë 27.9.2022, “Kthim përgjigje”.

⁴¹ MSHMS, SHSSH, Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK, nr.1381.prot, datë 28.7.2022, “Për procedurat e përfitimit të ndihmës ekonomike të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare”, drejtuar 12 Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

⁴² Kthim përgjigje, Drejtoria e Shërbimit Te Kujdesit Social Dhe Komunitar, Bashkia Elbasan,, 23.08.2022.

Bashkia Kamëz na informon se viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë përfituar ndihmë ekonomike pas aplikimit pranë administratorit shoqëror nga data 1-10 e muajit, pavarësisht se vendimi i gjykatës për lëshimin e UM ose UMM ka qenë ose jo i formës së prerë⁴³.

Bashkia Lezhë ka përcjellë informacionin se për periudhën Gusht-Shtator 2022 ka pasur 46 raste që kanë përfituar ndihmë ekonomike që gjatë aplikimit kanë qenë të pajisur me urdhra mbrojtje që nuk kanë marrë formë të prerë⁴⁴.

Së dhjeti, janë identifikuar raste kur sistemi i aplikimit të ndihmës ekonomike nuk funksionon ose ka probleme teknike.

Në përgjithësi, problemet teknike dhe mosfunksionimi i sistemit nuk kanë qenë pengesë për përfitimin nga skema e viktimave të dhunës në familje.⁴⁵ Kur kanë qenë në këtë situatë, Bashkia dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror kanë marrë masa për sigurimin e ndihmës ekonomike për viktimat e dhunës në familje. Kur ka pasur probleme teknike afatgjata, është miratuar shtyrja e aplikimeve nga SHSSH dhe bashkitë kanë informuar për shtyrje të afatit kohor të aplikimeve.

Me mosfunksionimin e sistemeve nga sulmi kibernetik referuar shkresës nr. 2019, datë 26.07.2022 nga Shërbimi Social Shtetëror i jepet e drejta kësaj kategorie për të përfituar ndihmë ekonomike edhe pa aplikuar në sistem.⁴⁶ Gjithashtu, në bashkinë Roskovec, në rastet kur sistemi mund të ketë probleme teknike, aplikimi mund të bëhet manualisht.⁴⁷ Përgatitja e listëpagesave në mënyrë manuale është kryer edhe në bashki të tjera, në marrëveshje me DRSSSH, me qëllim që viktimat e dhunës në familje të mos humbasin NE. Janë identifikuar edhe raste që janë afektuar në përfitimin e kësaj të drejte për shkak të problemeve teknike të sistemit⁴⁸.

⁴³ Bashkia Kamëz, nr.8550/1.prot, datë 26.09.2022, "Kthim përgjigje".

⁴⁴ Bashkia Lezhë, nr.5723/1, datë 28.9.2022, "Kthim përgjigje".

⁴⁵ Kthim përgjigje dhe Informacion mbi Viktimat e dhunës, Nr 3312/1 prot., Bashkia Sarandë, 09.02.2022.

⁴⁶ Përgjigje shkresës nr 209 prot. Dt. 25.07.2022, Bashkia Shkodër, Drejtoria e ndihmës Ekonomike dhe PAK, Nr. 2001/1 Prot , datë 12.08.2022.

⁴⁷ Informacion mbi situatën e dhunë në familje na Bashkinë Roskovec, Nr. 7062/1.prot., Bashkia Roskovec, 08.08.2020

⁴⁸ Në bazë të vendimit nr. 3306, datë 14.06.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë viktimat R.SH dhe dy fëmijët e saj të mitur janë pajisur me UM për një periudhë 12 mujore. Kohëzgjatja e UM është 14.06.2022-14.06.2023. Pas referimit që i është bërë këtij rasti nga QNL pranë KVDHF në Bashkinë Tiranë, viktimat është takuar me punonjësen sociale të njësisë administrative ku ka vendbanimin e saj dhe është ftuar të aplikojë për ndihmë ekonomike. Gjatë intervistës së realizuar me viktimën, na është bërë e ditur se fatkeqësisht gjatë muajit korrik dhe gusht 2022 sistemi i aplikimit për ndihmë ekonomike ka pasur probleme dhe për rrjedhojë nuk ka qenë e mundur të realizohet aplikimi. Në shtator 2022 viktimat ka aplikuar për ndihmë ekonomike, pasi është njoftuar nga punonjësja sociale mbi funksionimin normal të sistemit të aplikimit. R.SH do të përfitojë ndihmë ekonomike nga momenti i aplikimit, pra nga muaji shtator e në vazhdim. Ndërkohë për muajt korrik

Së njëmbëdhjeti, janë identifikuar praktika të profesionistëve që afektojnë të drejtën e viktimave të dhunës për NE.

Nga monitorimi kanë rezultuar raste ku policia nuk mbështet viktimën me përgatitjen e kërkesës për UMM/UM me pretendimin se kur dhunuesi arrestohet nuk ka rrezik të mundshëm për viktimën⁴⁹. Kjo sjell efekte jo vetëm në aspekte të sigurisë së jetës së viktimës, por edhe në lidhje me të drejtën e saj për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Në lidhje me gjykatat, nga informacionet e marra rezulton se janë identifikuar raste kur gjykatat e rretheve gjyqësore nuk janë shprehur në vendimin e UM mbi afatin e vlefshmërisë së urdhrit, duke cenuar të drejtën e viktimës së dhunës në familje për akses në ndihmën ekonomike⁵⁰.

Vonesat në zbardhjen e vendimit të gjykatës për lëshimin e UM sjellin pasoja në përfitimin e ndihmës ekonomike nga viktimat e dhunës në familje.

Gjatë monitorimit të kryer nga QNL mbi zbatimin e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën Janar – Dhjetor 2021, një nga problematikat e konstatuara është koha e gjatë që i duhet gjykatës për të arsyetuar dhe zbardhur vendimet e UM. Nga praktika e QNL është konstatuar se vendimet e lëshimit të UM zbardhen nga gjyqtarët pas disa ditësh, madje ka pasur raste edhe pas 30 ditësh. Dy palët në proces njihen me dispozitivin e vendimit të gjykatës në seancën gjyqësore ku shpallet publikisht vendimi për lëshimin e UM, por për vendimin e zbardhur iu duhet të presin disa ditë. De jure viktima është e pajisur me UM por de facto nuk posedon asnjë dokument që vërteton se ka një UM në favor të saj, deri në zbardhjen e vendimit.

Neni 17, pika 5 i ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, ka sanksionuar se gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes, u dërgon nga një kopje të vendimit: *a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim; b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë; c) zyrës së shërbimeve sociale të NJV, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim; ç) komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.* Megjithatë, në praktikë nuk respektohet ky afat. Ndërkohë, mbetet problem mos pajisja e viktimës me një vendim të shkurtuar, i cili mund të përdoret prej saj deri në zbardhjen e plotë të vendimit të UM nga gjykata.

dhe gusht 2022, R.SH nuk përfiton pagesat e NE së prapambetur.

⁴⁹ Bashkia Konispol, nr.855/1.prot, datë 9.8.2022, "Kthim përgjigje".

⁵⁰ Kthim përgjigje, nr.1950/1, datë 09.08.2022, Bashkia Klos.

Gjatë monitorimit të vendimeve të UMM/UMM dhe faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë konstatuar përmirësime në drejtim të përcaktimit në dispozitivin e vendimit mbi ekzekutimin e tij. Disa gjyqtarë kanë krijuar një praktikë, sipas të cilës në dispozitivin e vendimit nuk shprehen vetëm se ky vendim përbën titull ekzekutiv, por edhe se vendimi është i ekzekutueshëm nga momenti i shpalljes pavarësisht nëse ka marrë formë të prerë apo jo. P.sh.: “Ky vendim bazuar ne nenet 19/6 dhe 23 te ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 përbën titull ekzekutiv dhe duhet të ekzekutohet nga të gjitha institucionet që i drejtohet menjëherë pavarësisht nëse ka marrë ose jo formë të prerë.”⁵¹

Gjithashtu, bashki të caktuara na informojnë për pamundësi aplikimi në sistemin e ndihmës ekonomike për fëmijët, në rastet kur UM vë në mbrojtje edhe fëmijët, por nuk përmendet nga gjykata emri i plotë i fëmijëve⁵².

Së fundi, zbatimi i udhëzimeve të dërguara nga SHSSH⁵³ rezulton sfidues në bashki në lidhje me mundësinë e aplikimit të qytetarëve gjatë gjithë muajit, si edhe në lidhje me mundësinë e aplikimit të tyre me UM apo UMM pavarësisht nëse vendimi i gjykatës është ose jo i formës së prerë⁵⁴.

Bashkia Patos na ka përcjellë informacionin se “...rastet të cilat e kanë marrë UM pas datës 10 të një muaji të caktuar kanë aplikuar në muajin pasardhës dhe e kanë përfituar pagesën prej muajit që kanë aplikuar, jo prej muajit që është lëshuar UM, kjo pasi nuk kemi pasur asnjë udhëzim nga SHSSH se si do të veprohet në këto raste”⁵⁵.

Bashkia Kavajë, ka identifikuar si sfidë kryesore nevojën që administratori shoqëror duhet ta lexojë dhe interpretojë vendimin bashkë me një jurist, sepse ka raste që nuk kuptohet qartë nëse vendimi është lëshuar edhe për fëmijët e mitur apo vetëm për viktimën e dhunës në familje⁵⁶.

⁵¹ Vendimi nr. 859, datë 15.02.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “lëshimin e UM”.

⁵² Kthim përgjigje..., nr.3240/1, datë 8.8.2022, Bashkia Mat.

⁵³ MSHMS, SHSSH, Drejtorja e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK, nr.1381.prot, datë 28.7.2022, “Për procedurat e përfitimit të ndihmës ekonomike të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare”, drejtuar 12 Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

⁵⁴ Bashkia Fushë Arrëz, nr.3696/1.prot, datë 21.09.2022, “Kthim përgjigje”

⁵⁵ Bashkia Patos, 2311/1, prot, datë 28.09.2022, “Kthim përgjigje”.

⁵⁶ Bashkia Kavajë, nr.3237/1.prot, datë 29.9.2022, “Kthim përgjigje”.

III. PRAKTIKA TË MIRA NË PËRGJIGJE TË PROBLEMATIKAVE TË IDENTIFIKUARA

Në vijim janë evidentuar praktika të mira të konstatuara në disa bashki, të cilat janë përpjekur të zgjidhin disa nga problematikat e lartpërmendura nëpërmjet zgjidhjeve alternative:

III.1. Në lidhje me datat e aplikimit,

Në bashkinë Tropojë ndiqet një praktikë pozitive. Bashkia Tropojë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Kukës, kanë bërë të mundur shtyrjen e afatit në rastet kur viktimat e dhunës në familje merr vendimin e Gjykatës pas datës 11 të muajit. Së fundmi, Drejtoria e përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror është shprehur me urdhër duke unifikuar mënyrat që viktimat të mos humbë asnjë muaj nga përfitimi i ndihmës ekonomike.⁵⁷

III.2. Në lidhje me zbardhjen e vendimit nga gjykatat e rretheve gjyqësore,

Në bashkinë Bulqizë, në rastet kur viktimat e dhunës në familje nuk ka mundur të përfitojë nga skema e NE për shkak të vonesës nga Gjykata të UM/UMM, Drejtoria e Shërbimit Social ka ofruar disa paketa ushqimore për të mbuluar nevojat bazike për ushqim.⁵⁸

Në bashkinë Shkodër, në rastet kur ka vonesa në zbardhjen e vendimet për UM ose UMM, atëherë ata i drejtohen me shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për dërgimin në kohë të vendimeve gjyqësore dhe pajisjen e tyre me të dhënat përkatëse të rasteve, në mënyrë që punonjësi social të vihet menjëherë në kontakt me viktimën për të realizuar procedurat e menaxhimit të rastit.⁵⁹

⁵⁷ Bashkia Tropojë, nr.3306/1.prot, datë 08.08.2022. "Kthim përgjigje".

⁵⁸ Kthim përgjigje, Nr. 4975/1. Prot., Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Bulqizë, 01.08.2022.

⁵⁹ Përgjigje shkresës nr 209 prot. Dt. 25.07.2022, Bashkia Shkodër, Drejtoria e ndihmës Ekonomike dhe PAK, Nr. 2001/1 Prot , datë 12.08.2022.

Bashkia Lezhë ka përcjellë informacionin se “në mënyrë të vazhdueshme i është dërguar në formë shkresore gjykatës nevoja që urdhrat e mbrojtjes të na dërgohen sa më shpejt që të mos kemi vonesa aplikimi për ndihmën ekonomike”⁶⁰.

III.3. Në lidhje me rastet e vendqëndrimit të përkohshëm të ndryshëm nga vendbanimi i përhershëm,

Në bashkinë Tropojë, specialisti që menaxhon rastet bashkëpunon me zyrën përkatëse ku ka vendbanimin viktimë për të lehtësuar aplikimin, në mënyrë që viktimë mos të humbasë ndihmën ekonomike.⁶¹

Në mbledhjet e Mekanizmit të Referimit në Bashkinë Tiranë është referuar dhe diskutuar problematika e sipërpërmendur dhe është lehtësuar procesi i aplikimit në skemën e ndihmës ekonomike, rast pas rasti nga Koordinatori Vendor kundër Dhunës në Familje, në bashkëpunim me institucionet e linjës, veçanërisht me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe administratorët shoqërorë në Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë.

III.4. Në lidhje me informimin e viktimave të dhunës në familje mbi të drejtën e përfitimit të NE,

Në Bashkinë Berat⁶², viktimat e dhunës në familje, kur pajisen me UM kontaktohen menjëherë nga koordinatoresha për të aplikuar tek administratori shoqëror i rajonit përkatës për përfitimin e ndihmës ekonomike. Në kuadrin e punës së MKR në këtë bashki është me rëndësi të theksojmë se specialistët e policisë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë dhe specialistët e policisë së zonave i orientojnë viktimat të paraqiten në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, për tu informuar për përfitimet që kanë si viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Bashkia Kavajë përfaqësohet nga KVDHF në seancat e lëshimit të UM apo UMM për trajtimin e rastit në mbështetje të viktimës. Në rastet kur gjykata vendos lëshimin e UM apo UMM, pas marrjes së njoftimit të vendimit, KVDHF pranë DSHS asiston viktimën e dhunës duke e orientuar pranë zyrës së ndihmës ekonomike për tu trajtuar me NE, kur viktimë ka vendbanimin e përhershëm në këtë bashki ose e referon në bashkinë përkatëse nëse viktimë ka një vendqëndrim të përkohshëm⁶³.

⁶⁰ Bashkia Lezhë, nr.3365/1.prot, datë 24.8.2022, “Kthim përgjigje”

⁶¹ Bashkia Tropojë, nr.3306/1.prot, datë 08.08.2022. “Kthim përgjigje”.

⁶² Bashkia Berat, Nr.3776/1.Prot, datë 25.08.2022, “Kthim përgjigje”.

⁶³ Bashkia Kavajë, nr.2755/1.prot, datë 05.08.2022, Kthim përgjigje.

III.5. Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të KMD,

Bashkia Tiranë ndan informacionin se, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale me shkresën nr.25327/1 prot., datë 27.7.2022, ia ka përcjellë për njohje rekomandimin e Komisionerit të gjitha Njësive Administrative të Bashkisë Tiranë⁶⁴.

III.6. Në lidhje me mbështetjen e viktimave të dhunës në familje,

Sipas VKM-së sipërpërmendur, viktimat e dhunës në familje që nuk kanë mundur të sigurojnë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes, mund të marrin ndihmë ekonomike nëse plotësojnë kushtet si familje në nevojë, por jo si viktimë dhune.

Si praktikë, në bashkinë Klos, në rast se viktimat e dhunës në familje humbin të drejtën për të përfituar nga ndihma ekonomike për shkak të mungesës së një UM, atëherë ata i drejtohen me një kërkesë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale për t'i siguruar një ndihmë financiare.⁶⁵

Në bashkinë Krujë, rastet e dhunës janë trajtuar sipas Vendimit nr. 159, datë 12.02.2022, si dhe me çdo ndihmë monetare apo materiale me bazë ushqimore.⁶⁶

Bashkia Sarandë i ka trajtuar rastet që janë pajisur me UMM/UM pas datës 10 të muajit me të ardhurat e bashkisë, në pamundësi për ti trajtuar nga sistemi i menaxhimit të NE. Po ashtu edhe Bashkia Selenicë ka trajtuar me fondet e veta rastet me ndihmë ekonomike, ndihma ushqimore, veshmbathje, etj. në varësi të nevojave të viktimës. Bashkia Shijak gjithashtu ka ndjekur të njëjtën qasje në mbështetje të viktimave. Bashkia Sarandë duke konsideruar prioritare viktimat e dhunës në familje i ka trajtuar me ndihmë nga të ardhurat e saj edhe 6 muaj pas përfundimit të UM⁶⁷.

⁶⁴ Bashkia Tiranë, Nr.27092/1, prot, datë 5.8.2022, "Kthim përgjigje".

⁶⁵ Dërgim informacioni, Nr. 3966/1. Prot, Bashkia Kurbin, 10.08.2022.

⁶⁶ Kthim përgjigje, nr. 1083 Prot., Bashkia Krujë, 11.08.2022.

⁶⁷ Bashkia Sarandë, Nr 3312/1, prot, datë 09.02.2022, "Informacion mbi viktimat e dhunës".

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

- Konstatohet se ka nevojë të përmirësohet kuadri ligjor në zbatim të rekomandimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁶⁸, në mënyrë specifike rishikimi i pikës 6 të nenit 12, të ligjit nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 12, të Kreut III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 4.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujorë të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, me qëllim sigurimin e aksesit paralel të viktimave të dhunës në familje, si viktimat e dhunës dhe si kategori në nevojë, për shkak të mungesës ose pamjaftueshmërisë së të ardhurave”.
- MSHMS duhet të marrë masa të menjëhershme që viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të përfitojnë ndihmën ekonomike, që nga momenti kur gjykata merr vendimin për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM) dhe gjatë gjithë vlefshmërisë së tij, pavarësisht se kohëzgjatja mund të jetë më pak se 1 (një) muaj. Gjithashtu, po në zbatim të rekomandimit të KMD, MSHMS dhe SHSSH të marrin masa të menjëhershme, për të udhëzuar të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore/administratorët shoqërorë, të procedojnë me aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike, nëse viktimat e dhunës në familje depozitojnë vendimin e shkurtuar/dispozitivin e gjykatës që ka vendosur lëshimin e urdhrit të mbrojtjes apo urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, me qëllim shmangien e vonësive në përfitimin e NE, deri në zbardhjen e plotë të vendimit gjyqësor.
- Të rishikohen nga SHSSH praktikat e ndjekura nga administratorët shoqërorë, me qëllim krijimin e lehtësive në aplikimin e viktimave të dhunës në familje për ndihmë ekonomike dhe përfitimin kur vendbanimi i tyre i qëndrueshëm është i ndryshëm nga vendqëndrimi i përkohshëm. Shpesh, situata social-ekonomike e viktimave dhe çështjet e sigurisë nuk e mundësojnë lëvizjen e tyre për të bërë aplikimin për herë të parë dhe paraqitjen çdo tre muaj për të bërë deklaratën.

⁶⁸ Rekomandim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nr.1636.Prot, datë 25.11.2021.

- SHSSH të marrë masa për unifikimin e praktikave mbi mos kushtëzimin e NE për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, me marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes (UM) dhe përfitimin e NE që nga momenti që gjykata ka lëshuar Urdhrin e Mbrojtjes (UM).
- Të ndërmerren iniciativa ligjore me qëllim që të mos lejohet vendosja në sekuestro apo ngrirja e NE-së për viktimat e dhunës në familje të pajisura me UMM/UM;
- Sugjerohet që SHSSH ta shoqërojë shkresën e Korrikut të 2022, në zbatim të rekomandimeve të KMD edhe me orientime konkrete dhe praktike për zbatimin e tyre.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor të udhëzojë gjykatat, që brenda 24 orëve nga shpallja e vendimit për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM) ose urdhrit të mbrojtjes (UM), viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të pajiset me vendimin e shkurtuar/dispozitivin e gjykatës, me qëllim shmangien e vonesave deri në zbardhjen e plotë të vendimit gjyqësor.
- Organizimi i një Forumi të Hapur Diskutimi i SHSSH, Drejtorive rajonale të shërbimit social, drejtueseve të shërbimeve sociale në bashki, administratorëve shoqërorë, KVDHF, PMF dhe përfaqësues të gjyqësorit, me qëllim diskutimin e shqetësimeve të krijuara nga praktika e gjyqtarëve në procesin e lëshimit të UMM/UM dhe efektet e saj në përfitimin e NE nga viktimat.
- Rekomandohet të forcohet puna e KVDHF për informimin e viktimave që në momentin e parë, në lidhje me të drejtat e tyre, përfshi të drejtën për ndihmë ekonomike.
- MSHMS dhe aktorë të tjerë të përfshijnë në fokusin e trajnimeve për njësitë kundër dhunës në familje dhe KVDHF edhe diskutimin e aspekteve ligjore dhe praktike të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike për viktimat e dhunës në familje.
- Forcimi i punës së organizatave të shoqërisë civile në lidhje me informimin, këshillimin, ndihmën juridike parësore dhe dytësore, lobimin dhe advokacinë, me qëllim aksesin efektiv të viktimave në NE dhe përfitime të tjera.
- KMD të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të tij, dhe të marrë masat e nevojshme në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”.

ANEKS I: TË DHËNA MBI VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE QË KANË PËRFITUAR NDIHMË EKONOMIKE GJATË 2020, 2021 DHE 2022 SIPAS BASHKIVE.

Nisur nga problematikat e identifikuara në praktikën e mbështetjes së viktimave të dhunës në familje me ndihmë ligjore falas, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur një kërkesë për informacion drejtuar 61 bashkive në vend nga të cilat 49 bashki kanë dërguar informacion në lidhje me arritjet dhe sfidat në aksesin e viktimave në ndihmën ekonomike.

Aneks 1: Numri i viktimave të dhunës në familje që kanë përfituar ndihmë ekonomike si viktima dhune në familje të pajisura me UMM, dhe numri i viktimave të dhunës në familje të pajisura me UM, gjatë viteve 2020, 2021, dhe 2022. ⁶⁹

Nr.	Bashkia	2020		2021		2022	
		Viktima dhune në familje që kanë përfituar ndihmë ekonomike	Me UM/ UMM	Viktima dhune në familje që kanë përfituar ndihmë ekonomike	UM/ UMM	Viktima dhune në familje që kanë përfituar ndihmë ekonomike	UM/ UMM
1.	Belsh	-	-	-	-	4	4 UMM (2020-2022)
2.	Bulqizë	7	5 UMM/ 2UM	6	4 UMM/ 2 UM	7	6 UMM/ 1 UM
3.	Cërrik	12	12 UM	14	13 UM/ 1 UMM	7	6 UM/ 1 UMM
4.	Devoll	-	-	6	6 UM (7 viktima me UMM nuk kanë aplikuar dhe përfituar nga NE)		
5.	Dibër	Nuk ka informacion.	-	Nuk ka informacion.	-	Nuk ka informacion.	12 UM (2020-2022)
6.	Dimal ⁷⁰	-	-	-	-	9 (2020-2022)	45 UM/UMM (2020-2022)
7.	Fushë-Arrëz	3	3 UM	2	5 UM	-	-
8.	Gramsh	13	13 UM	4	2 UM/ 2 UMM	3	3 UM

⁶⁹ Tabela është plotësuar me informacionin dhe të dhënat e marra nga bashkitë gjatë muajit Gusht 2022.

⁷⁰ Në bashkinë Dimal, nga 45 viktima të dhunës në familje me UMM dhe UM gjatë 2020-202, vetëm 9 viktimave të dhunës në familje kanë përfituar ndihmë ekonomike.

9.	Has	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion
10.	Kamëz	39	39 UM/UMM	47	47 UM/UMM	38	38 UM/UMM
11.	Kavajë	7	7 UM ose UMM	8	8 UM ose UMM	6	6 UM ose UMM
	Klos	7	7 UM/UMM	16	16 UM/UMM	4	4 UM/UMM
12.	Korçë	14	14 UM	18	18 UM	14	14 UM
13.	Krujë	24	24 UMM/UM	70	70 UMM/um	43	43 UMM/um
14.	Kuçovë	7	7 UM	5	5 UM	5	5 UM
15.	Kukës	15	15 UM	12	12 UM	6	6 UM
16.	Kurbini	Nuk ka informacion.	32 UM	Nuk ka informacion.	47 UM	30	48 UM
17.	Lushnjë ⁷¹	-	-	-	-	-	-
18.	Mat	Nuk ka informacion.	4 UM	Nuk ka informacion.	11 UM	Nuk ka informacion	15 UM
19.	Mirditë	Nuk ka informacion.	12 UM / 15 UMM	Nuk ka informacion.	5 UM / 7 UMM	Nuk ka informacion.	16 UM / 18 UMM
20.	Patos	22	22	15	16 (një rast është larguar nga vendi)	7	7
21.	Poliçan ⁷²	-	-	-	-	-	-
22.	Përrenjas	6	6 UM	11	11 UM	2	2 UM
23.	Pustec	Nuk ka informacion	-	Nuk ka informacion	-	Nuk ka informacion	2 UMM/UM (2020-2021)
24.	Përmet	-	-	-	-	-	2 (2020-2022)
26.	Roskovec	-	-	-	-	16 (2020-2022)	16 UM/UMM (2020-2022)
27.	Sarandë	21	2 UMM/19 me UM	27	2 UMM/25 me UM	17	17 UM/UMM
28.	Selenicë	3	1 UMM	4	1 UM / 3 UMM	1	1 UMM
29.	Shkodër	234	234 UM; 0 UMM	384	384 UM (0 UMM)	306	306 UM (0 UMM)
30.	NJA Thumanë	7	7 UM / 9 UMM	6	6 UM / 8 UMM	11	11 UM / 4 UMM
31.	Tiranë ⁷³	118	118 UM	178	178 UM	230	230 UM
32.	Tropojë	4	4 UM	Nuk ka informacion	1 UM	Nuk ka informacion	1 rast në proces për UM
33.	Vorë	-	-	-	-	37 (2020-2022)	42 UM (2020-2022)

⁷¹ Në bashkinë Lushnje, viktimat e dhunës në familje të pajisura me UM dhe UMM nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike, por kanë përfituar pagesën e Urdhrit të Mbrojtjes të caktuar nga Gjykata sipas një afati të caktuar. Nga 2022, kanë nisur procedurat që viktimat e dhunës në familje të aplikojnë që të përfitojnë dhe ndihmën ekonomike pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore në Bashkitë/Njësitë vendore nga data 1-10 të çdo muaji për të përfituar ndihmën ekonomike.

⁷² Në bashkinë Poliçan, nuk ka patur raste të dhunës në familje, të cilat kanë përfituar pagesën si viktimë e dhunës në familje, pasi nuk kanë qenë të pajisur me UM, por vetëm me UMM. Kjo i ka penalizuar që të marrin edhe një muaj të vetëm pagese.

⁷³ Bashkia Tirane nuk ka patur përfitues të ndihmës ekonomike të pajisur me UMM.

34.	Pustec	Nuk ka informacion	2UM	-	-	-	-
35.	Mirditë	Nuk ka informacion	12UM/ 15UMM	Nuk ka informacion	7UMM/ 5UM	Nuk ka informacion	16UM/ 18UM
36.	Selenicë	3	1UMM/2UM	4	1UM/ 3UMM	1	1UMM
37.	Vorë	-	-	-	-	37 (2020 -2022)	42UM (2020 -2022)
38.	Kucovë	7	7UM	5	5UM	5	5UM
39.	Dropull	-	-	-	-	1	1UM
40.	Vlorë	4	4UM	23	23UM	25	25UM
41.	Skrapar	-	-	1	1UMM/UM	-	-
42.	Malla-kastër	10	10UM	15	15UM	22	22UM
43.	Konispol	1	1UM	-	-	-	-
44.	Shijak	2	2UM	2	2UM	3	3UM
45.	Libohovë	-	-	-	-	-	-
46.	Kolonjë	-	-	3	3UM/ UMM	3	3UM/UMM
47.	Himarë ⁷⁴	-	-	-	-	-	-
48.	Elbasan ⁷⁵	75	124Um/ UMM	25 (nga viti 2020) + 90	144UM/ UMM	80	80UM/ UMM
49.	Lezhë	55	55UMM/ UM	36	36UMM/UM	52	52UMM/ UM

Bashkia Mat ka dhënë informacion në lidhje me numrin e UM/UMM për tre vitet e monitorimit, por nuk është e qartë sa prej këtyre rasteve kanë përfituar ndihmë ekonomike.⁷⁶ Në mënyrë të ngjashme, bashkitë Tropoje, Vorë dhe Kurbin kanë reflektuar vetëm mbi rastet e UM/UMM dhe pa dhënë një informacion më të thelluar në lidhje me rastet që kanë përfituar ndihmë ekonomike.

⁷⁴ Bashkia Himarë nuk ka ofruar asnjë shërbim për viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare të pajisura me UM dhe UMM pasi urdhrat e mbrojtjes vijnë me shumë vonesë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në zyrat e shërbimit social dhe nuk respektohet afatet e plotësimit të formularëve për të përfituar ndihmën ekonomike.

⁷⁵ Për periudhën kohore 2020-2021-2022 ka një trend në rritje të rasteve të dhunës në familje. Rritja e ndërgjegjesimit nga anëtarët e MKR-së ka sjellë edhe një raportim më të lartë të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Në vitin 2020 janë menaxhuar nga MKR 124-raste, prej të cilëve kanë përfituar Ndihmë Ekonomike për shkak të UMM/UM 75-raste të reja dhe 29-raste të mbartur nga viti 2019. Në vitin 2021 janë menaxhuar nga MKR 144-raste prej të cilëve: 90-raste të pajisur me UMM/UM dhe 25-raste të mbartur nga viti 2020 janë trajtuar me Ndihmë Ekonomike si viktima dhune në familje. Për vitin 2022 deri në muajin korrik, mesatarisht janë 80-raste të pajisur me UMM/UM përfitues në skemën e Ndihmës Ekonomike për shkak të pajisjes me UMM/UM.

⁷⁶ Kthim përgjigje shkresës me nr. 185. Prot, datë 25.07.2022, Bashkia Mat, 08.08.2022.